Kjo pasqyrë publikohet në interes të informimit sa më të drejtë dhe në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet ekonomike në vend. Përmes mënyrave të tilla të komunikimit Ministria e Financave mundohet që të shfrytëzojë të dhënat e disponueshme nga institucionet e vendit për të dhënë një pamje të përmbledhur mbi ekonominë në vend.

Sektori Real

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 u rrit me një normë reale prej 4%, shifër kjo që mbetet vlerësim meqë ende nuk janë të gatshme të dhënat finale lidhur me këtë tregues.

Ky ndryshim (nga norma prej 3.6% në edicionin e kaluar të kësaj pasqyre) vjen si pasojë e publikimit të BVP-së për tremujorin e fundit të vitit 2015, i cili tashmë i është shtuar vlerësimit vjetor për BPV-në.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar edhe BPV-në për tremujorin e parë të këtij viti, i cili në krahasim me tremujorin e parë të vitit paraprak paraqet një rritje prej 3.8%.

Grafiku 1. BPV reale sipas qasjes së shpenzimeve, me çmime konstante *(në milionë euro)*



Nga grafiku 2 shohim se niveli i çmimit të produkteve ushqimore ka shënuar rënie gjatë këtij tremujori, veçanërisht gjatë muajit qershor. Niveli i përgjithshëm i çmimeve mbajti nivel të ngjashëm me periudhën paraprake dhe vazhdon të përcjellë ngushtë nivelin e çmimit të produkteve ushqimore.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit



Gjatë periudhës prill – maj të këtij viti shohim se u shënua deflacion prej 0.2% në mesatare.

Për të kuptuar më shumë mbi gjendjen e ekonomisë në vend, u referohemi treguesve siç janë numri i bizneseve të regjistruara dhe perceptimet e bizneseve. Më tutje do të paraqesim bizneset e reja të regjistruara në sektorët e ndryshëm të ekonomisë në Kosovë, për t'u përcjellë me një analizë të përshtypjeve që bizneset kanë mbi klimën biznesore në vend.

Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë gjatë kësaj periudhë u regjistruan 2801 biznese, prej të cilave mbi 700 në sektorin e tregtisë, ndërkaq mbi 300 në prodhim.

Tabela 1. Numri i bizneseve të regjistruara

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM2 2015	TM2 2016
Tregti me shumicë dhe pakicë	751	779
Prodhim	261	334
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	212	223
Ndërtimtari	193	202
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	263	326
Të tjera	807	937
Totali	2487	2801

Vlen të theksohet se nga kategoritë më sipër, në krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar më së shumti janë regjistruar biznese në sektorin e prodhimit; rreth 73 biznese më shumë.

'Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim' po ashtu karakterizohet me rritje të numrit të bizneseve; deri ne fund të tremujorit të dytë të këtij viti janë regjistruar 63 biznese më shumë në këtë sektor krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

Pjesa vijuese paraqet një shqyrtim të përgjithshëm të vlerësimit të klimës së biznesit në vend, sipas përshtypjeve të kompanive, të krahasuara në periudhat përkatëse. Këto të dhëna mundësohen përmes anketës tremujore të Odës Ekonomike të Kosovës.

Grafiku 3 tregon pozitën e sektorëve të dhënë sipas vlerësimeve të bizneseve (balanca) dhe lëvizjes nga ky vlerësim krahasuar me periudhën paraprake (në pikë përqindjeje).

Grafiku 3. Klima e biznesit në TM2 2015



Në tremujorin e dytë të vitit të kaluar situata ishte vlerësuar përgjithësisht pozitive. Një vlerësim i tillë përcolli edhe tremujorin e dytë të këtij viti, veçanërisht për sektorin e ndërtimtarisë dhe shitjes me pakicë. Tre sektorët e mbetur karakterizohen me përkeqësim në raport me tremujorin paraprak, mirëpo megjithatë vlerësimi aktual mbetet pozitiv.

Grafiku 4. Klima e biznesit në TM2 2016



Grafiku 5 jep pritjet e bizneseve mbi klimën që ata presin të mbizotërojë për muajt në vijim.

Është karakteristike se pritjet për gjashtë muajt në vijim janë pozicione shumë të ngjashme me vlerësimet për situatën aktuale, ku bizneset kanë pritje përgjithësisht pozitive por duket të jenë skeptike për periudhën përtej gjashtë muajve në fjalë ('përkeqësimi').

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM2 2016 për gjashtë muajt e ardhshëm



Përshtypjet e tilla mund të burojnë nga pasiguria e lidhur me situatën politike në vend. Megjithatë, është për t'u vlerësuar se asnjëri prej sektorëve nuk shtrihen në kuadratet e poshtme, pra kemi të bëjmë me një përshtypje përgjithësisht pozitive.

Sektori i Jashtëm

Tregtia e jashtme vazhdon të mbajë trendët e deritanishme, ku përgjatë periudhës prill-qershor të këtij viti u importuan mallra në vlerë prej mbi 700 milionë euro.

Tabela e mëposhtme tregon katër grupe produktesh që përbejnë rreth gjysmën e importit total. Ka një rritje prej 5.2% të importit total nëse krahasojmë me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, *në '000 euro*

Kategoria	TM2 2015	TM2 2016
Ushqim, pije, duhan	91,079	96,219
Produkte minerale	110,488	77,771
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	71,435	75,611
Makineri, pajisje makinerike e elektrike	73,700	92,451
Të tjera	352,993	393,991
Totali	699,695	736,043

Mbi 40% e importit total vjen nga shtetet e Bashkimi Evropian, ndërkaq afro 30% nga shtetet e CEFTA-s. Në tabelën më poshtë janë paraqitur disa prej shteteve prej të cilave Kosova importon më së shumti. Rritjen më të madhe e vërejmë tek importi nga Turqia, Gjermania dhe Kina, ndërkaq importi nga Italia ka shënuar një rënie prej 9%, megjithëse vlera e importit nga ky shtet vazhdon të mbetet e lartë.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, *në '000 euro*

Shteti	TM2 2015	TM2 2016
Gjermania	77,008	91,016
Italia	60,457	54,835
Serbia	96,607	96,786
Turqia	68,220	82,836
Kina	56,313	62,926
Të tjera	341,091	347,644
Total	699,696	736,043

Në anën tjetër, eksporti përgjatë kësaj periudhe arriti në mbi 80 milionë euro.

Tabela 4. Eksporti sipas produkteve, *në '000 euro*

	TM2 2015	TM2 2016
Produktet minerale	8,023	17,247
Metalet bazë dhe artikuj	45,427	28,650
Plastika, goma dhe artikuj	7,386	8,416
Të tjera	24,650	26,163
Total	85,486	80,476

Shohim nga tabela se ka një rënie të dukshme në eksportin e metaleve në krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar. Gjatë këtij tremujori kjo kategori përbën rreth 35% të eksportit total përderisa në të kaluarën ka përfaqësuar gjysmën e eksportit total. Në këtë tremujor shohim edhe se është rritur eksporti i produkteve të plastikës, edhe pse baza mbetet e ulët.

Mbi gjysma e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së; disa prej shteteve ku është eksportuar më së shumti janë:

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, *në '000 euro*

	TM2 2015	TM2 2016
Italia	6,471	1,613
Shqipëria	11,931	11,517
Maqedonia	10,244	11,342
Serbia	6,299	10,010
India	11,959	1,459
Të tjera	37,604	44,535
Total	84,508	80,476

Shohim se ka rënie të theksuar në eksportin për Itali dhe Indi (përkundër viteve të kaluara, gjatë kësaj periudhe eksport në Kinë nuk ka fare), ndërkohë që eksporti për në shtetet tjera mban nivele te ngjashme me periudhën e njëjte të vitit paraprak. Shohim një rritje më të theksuar tek eksporti në Serbi, megjithëse baza mbetet e ulët. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen dominuese të metaleve në eksportin kosovar, rënia e eksportit të këtij produkti vazhdon të ndikojë dukshëm eksportin total, prandaj shohim një rënie prej rreth 5% në eksportin total edhe për këtë periudhë.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore performuan mirë gjatë kësaj periudhe, duke shënuar një rritje prej rreth 13% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015.

Grafiku 6. Të hyrat*, *në milionë euro*



Shpenzimet në anën tjetër mbajtën nivele të përafërta me ato të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar një rritje të lehtë prej 1.5%.

Grafiku 7. Shpenzimet, *në milionë euro*



Në grafikun 8 janë paraqitur të hyrat dhe shpenzimet në raport me deficitin primar.

* së fundmi Ministria e Financave ka ndryshuar mënyrën e raportimit të të hyrave. Përderisa në të kaluarën të hyrat janë ndarë në 'vendore' dhe ato 'nga kufiri', tashmë ato ndahen sipas llojit; 'direkte' dhe 'indirekte'. Prandaj këto të dhëna mungojnë për periudhën para vitit 2015.

Grafiku 8. Të hyrat, shpenzimet dhe deficiti primar



Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë mbetet i kapitalizuar mirë, ku sipas Bankës Qendrore të Kosovës, shohim se ne fund të qershorit të këtij viti depozitat shënuan një rritje prej 4.6%, ndërkaq kreditë u rritën me 8.4% në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2015. Asetet totale shënuan rritje prej 5%, duke arritur në 3.4 miliardë euro në fund të periudhës.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës *(në milionë euro)*

	TM2 2015	TM2 2016
Depozitat	2,575	2,693
Kreditë	2,005	2,174
Asetet Totale	3,270	3,432

Banka Qendrore ofron edhe të dhëna mbi shpërndarjen e kredive nëpër sektorë të ekonomisë, prej ku mund të shohim se në përgjithësi ka pasur rritje prej 5% të kredive.

Kjo rritje është shtyrë nga rritja e kredive në sektorin e Shërbimeve në përgjithësi si dhe në sektorin e Bujqësisë. Megjithëse vlera e kredive në këtë të fundit është e vogël (56 milionë euro në fund të qershorit të këtij viti), rritja prej mbi 10% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është sinjal pozitiv. Shohim nga tabela se tregtia (me shumicë dhe pakicë) është sektori që prinë për nga vlera e kredive, me mbi 700 milionë euro në fund të periudhës.

Tabela 7. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik *(në milionë euro)*

(kumulative, fundi i periudhës)	TM2 2015	TM2 2016
Bujqësia	51	56
Industria dhe energjetika	208	217
Ndërtimtaria	104	101
Tregtia me shumicë dhe pakicë	723	731
Shërbimet fin., patundshmëri, qira, etj.	73	101
Shërbimet tjera	181	201
Gjithsej	1,340	1,409

Tabelë përmbledhëse

Përshkrimi	TM2 2015			TM2 2016		
në milionë euro, për muaj, përveç ku ceket ndryshe	Prill	Maj	Qershor	Prill	Maj	Qershor
Sektori Real						
Bruto Produkti Vendor	:	:	1,471	:	:	: *
IÇK *(ndryshimi në %, mujore)*	-0.4	-0.5	-0.4	-0.1	-0.1	-0.3
Sektori i Jashtëm						
Importi i mallrave	224	238	238	251	238	247
Eksporti i mallrave	28	26	30	23	27	30
Bilanci tregtar	-196	-210	-207	-227	-211	-216
Sektori Fiskal						
Të hyrat e përgjithshme	111	102	117	158	129	119
prej te cilave:						
Të hyrat nga tatimet direkte	30	10	13	37	13	13
Të hyrat nga tatimet indirekte	86	86	94	95	106	98
Shpenzimet e përgjithshme	78	121	134	113	130	141
prej te cilave:						
Shpenzimet rrjedhëse	77	101	97	93	109	95
Shpenzimet kapitale	1	18	32	19	20	45
Sektori Financiar *(kumulative, fundi i periudhës)*						
Depozitat	2578	2574	2575	2652	2675	2693
Kreditë	1936	1957	2005	2103	2143	2174
Asetet totale të sektorit financiar	3257	3262	3267	3382	3422	3432

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna: në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi
* të dhënat nuk janë të gatshme në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

Departamenti për Politika Ekonomike dhe Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Gusht 2016